

eppc kërkon një *Project Manager* për implementimin e një projekti të rëndësishëm për klientin e saj, i cili është një ndër kompanitë më prestigjioze në sektorin e kujdesit shëndetësor.

### NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM:

Kompania është në kërkim të një kandidati i cili duhet të ketë njohuri dhe përvojë në menaxhim projektesh. Kandidati ideal do të jetë përgjegjës për realizimin në kohë dhe me efikasitet brenda buxhetit të përcaktuar të gjithë ecurisë së projektit.

### Përgjegjësitë Kryesore:

- Menaxhon projektin duke sjellë efektivitet në kosto, cilësi dhe kohë;
- Planifikon, drejton organizon dhe kontrollon aktivitetet dhe rezultatet e projektit;
- Drejton dhe udhëheq skuadrën e projektit duke koordinuar punën me ta;
- Përgatit raporte dhe analiza me qëllim vlerësimin e ecurisë së projektit;
- Raporton tek CEO.

### Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë Universitare në Menaxhim, Mjekësi ose Informatikë;
- Eksperiencë e mëparshme jo më pak se 2 vjecare në menaxhim projektesh;
- Eksperiencë e mëparshme në supervizim ose menaxhim projektesh në industrinë e kujdesit shëndetësor (*përbën avantazh*);
- Njohje të shkëlqyer të gjuhës Angleze dhe paketës MS Office (*domosdoshmëri*);
- Të ketë aftësi shumë të mira drejtimi, vendimmarrjeje, planifikimi dhe organizimi;
- Të ketë aftësi të mira komunikuese, koordinuese dhe bashkëpunuese;
- Të ketë leje drejtimi automjeti dhe fleksibilitet për të udhëtuar (*domosdoshmëri*).

### Të dhënat:

Pozicioni:	Project Manager;
Vendndodhja:	Qendër, Tiranë;
Orari:	40 orë në javë;
Raporton tek:	CEO;
Udhëtime pune:	Po, brenda vendit;
Pagesa:	Ndër më të mirat në treg;
Kontrata:	Sipas Kodit të Punës;
Aplikimet mbyllen:	22 Prill 2015.

### Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke **përmendur pozicionin për të cilin aplikoni** në adresën e e-mail-it:

[recruitments@eppc.al](mailto:recruitments@eppc.al)

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen. Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.